



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1131/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesues, Milena Đerić dhe Adnan Konushevci anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Podujevë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, në rrjetin social Facebook, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të datës 14.11.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 15.11.2021, mori këtë

V E N D I M

I. PRANOHET si e bazuar ankesa Anr.1131/2021, e datës 14.11.2021 e paraqitur nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ndërsa Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, në rrjetin social Facebook, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të datës 14.11.2021, i shqiptohet gjobë, në lartësi prej 800.00 (tetëqind) euro.

II. DETYROHET Subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së këtij vendimi, nën kërcënim e shqiptimit të dënimit shtesë.

A r s y e t i m

Me datë 14.11.2021, PZAP-i ka pranuar ankesën Anr.1131/2021, e paraqitur nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, në të cilat pretendon se me datë me datën 14.11.2021 rreth orës 13:00 aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje kanë vërejtur se aktivisti i LDK-së Granit Hasani ka shpërndarë foto të kandidatit për Kryetar të Komunës së Podujevës Ekrem Hyesni, ku ka bërë thirrje që të votohet i njëjti. Foto të tjera të ngjashme ka postuar edhe aktivisti i LDK-së Fidan Rekaliu. Si dëshmi kanë bashkangjitur 2 fotografi të nxjerra nga rrejtja social Facebook.

Në përgjigje në ankesë subjekti politik LDK e mohon se ka ndodhur shkelja e supozuar pasi që parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse pasi që nga fotot nuk mund të vërtetohet se kur janë bërë postimet e supozuara pasi që me asnjë prove nuk është argumentuar data dhe ora e këtyre postimeve. Gjithashtu theksojnë së sa i përket Granit Hasanit për të njëjtin nuk mund të vërtetohet se është aktivist i LDK-së.

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, provave materiale,, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga shkresat e lëndës shihet se Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovë, konkretisht mbështetësit e këtij subjekti Granit Hasani dhe Fidan Rekaliu, gjatë heshtjes zgjedhore - ditës së votimit në rrjetin e saj social Facebook përmes postimeve në rrjetin social Facebook, kanë bërë fushatë zgjedhore ku përmes postimeve kanë bërë thirrje që të votohet kandidati për kryetar në Komunën e Podujevës nga Lidhja Demokratike e Kosovës Ekrem Hyesni, ku me këtë veprim kanë bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Paneli, konform nenit 8 par. 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr. 02/2015, me datë 14.11.2021 ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës, dhe gjeti se të njëjtat pretendime janë të bazuara, për faktin se në llogarinë e Facebook-ut, ashtu siç pretendon paraqitësi i ankesës për postimin e Granit Hasani, në ditën e votimit, i njëjti postim është bërë me datë 14.11.2021, rreth orës 13:00 dhe në kohën e verifikuar nga PZAP, ka qenë ende aktive dhe e shfaqur, ndërsa postimi i Fidan Rekaliut është publikuar me datë 14.11.2021, rreth orës 12:00 dhe në kohën e verifikuar nga PZAP, ka qenë ende aktive dhe e shfaqur, ku në këtë mënyrë kanë thyer heshtjen zgjedhore.

Andaj Paneli, duke iu referuar të cekurave më lart dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së konstaton se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, është përgjegjëse për veprimet e tija, pasi që me veprimet e lartcekura ka shkelur nenin 36 paragrafi 1 pika b) të LZP-së, që përcakton se: *“veprimet e ndaluara para procesit të votimit ku thuhet se 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja e fushatës në çfarëdo mënyre”*.

Në raport me pretendimet e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), se parashtuesi i ankesës nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse pasi që nga fotot nuk mund të vërtetohet se kur janë bërë postimet e supozuara pasi që me asnjë prove nuk është argumentuar data dhe ora e këtyre postimeve, Paneli i vlerësoi si të pabazuara ngase me dispozita ligjore, subjekteve politike apo kandidatëve të tyre iu ndalohet të bëjnë fushatë, në një mënyrë apo tjetër 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit dhe se ka qenë ende aktiv postimi është vërtetuar pas verifikimeve të bëra nga PZAP, andaj si e tillë konsiderohet se është bërë shkelje e heshtjes zgjedhore prandaj edhe se ankesa e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) është e bazuar.

Paneli, me rastin e shqiptimit të gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, u mbështet në dispozitat e lart cituara, e në veçanti duke marrë parasysh rrethanat e rastit siç janë: natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj, në procesin zgjedhor, shkallën dhe peshën e shkeljes, faktin se subjekti politik të cilit i është shqiptuar gjoba, ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, shumë e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, vlerëson se gjoba e shqiptuar si masë, përveç aspektit të dënimit në raport me subjektin që nuk e ka respektuar Kodin e Mirësjelljes, shërben edhe si masë preventive që në të ardhmen subjektet politike të përmbahen nga veprimet e tilla që bien ndesh me rregullativën ligjore, që cenojnë të drejtën apo lirinë e votimit, në mënyrë që të sigurohet

klime e qete dhe e pershtatshme per votim te lire dhe te pa ndikuar si bazament i nje procesi demokratik zgjedhor.

Nese subjekti te cilit i eshte shqiptuar denimi nuk e paguan te njejtin brenda afatit te percaktuar ne dispozitiv te tij, atehere ne pajtim me nenin 120.2 te LZP-se, subjektit do ti shqiptohet denim shtese. Ky paralajmerim per denim shtese eshte percaktuar me nenin 120.2 te LZP, i cili percakton: "120.2 Dështimi për të paguar dënimin apo për t'ju bindur një urdhërese të PZAP-it brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP-it, është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i.", ashtu siç është vendosur në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli mbi bazën e të dhënave të lartcekuar në mbështetje të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.1131/2021 më datë 15.11.2021

Kryesues i Panelit
Ferki Xhafri



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.